



KOLEGJI ESLG

Rregullore e Punës e Instituteve Hulumtuese

Neni 1

Institutet hulumtuese janë njësi autonome në kuadër të KOLEGJI ESLG-së. Institutet veprojnë brenda kornizave të Universitetit, në pajtim me procesin arsimor dhe hulumtues të Bolonjës.

Neni 2

Detyrat e Instituteve Hulumtuese janë si vijon:

- Qëllimi i tyre kryesor është zhvillimi i punës themelore hulumtuese shkencore në fusha të ndryshme shkencore.
- Institutet hulumtuese duhet të zhvillojnë projekte interdisiplinare të hulumtimit në Universitet.
- Institutet hulumtuese zhvillojnë aktivitete hulumtuese dhe zhvillimore në formë të projekteve dhe programeve të përqëndruara kryesisht në hulumtim elementar dhe atë të aplikuar.
- Në të ardhmen instituti duhet të kryejë hulumtim industrial.
- Institutet hulumtuese bashkëpunojnë me institute hulumtuese-shkencore të jashtme, e posaçërisht me institutet hulumtuese të Fakultetit Evropian të Drejtësisë nga Nova Gorica.
- Qëllimi i instituteve hulumtuese duhet të jetë inkorporimi i aktiviteteve të tyre hulumtuese me projektet shkencore vendëse dhe ndërkombëtare.
- Institutet hulumtuese të organizojnë konferenca kushtuar punës së tyre hulumtuese-shkencore.
- Institutet hulumtuese janë të lira të bashkëpunojnë me shkencëtarë të jashtëm.

Neni 3

Nazim Gafurri 33 Prishtinë Republika e Kosovës
T: +383 44 159 867
E: info@eukos.org
W: www.eukos.org



Organet e Institutit Hulumtues janë si vijon:

- Bordi i Institutit Hulumtues
- Drejtori i Qendrës Hulumtuese

Neni 4

Drejtorët e instituteve hulumtuese janë përgjegjës për punën e instituteve. Ata duhet të koordinojnë punën e tyre me prorektorin për hulumtime shkencore të universitetit.

Neni 5

Bordi i Institutit Hulumtues përbëhet prej:

- Drejtorit të Institutit Hulumtues;
- Drejtorit të departamentit apo programit përkatës të studimit;
- Tre anëtarë nga stafi akademik;
- Një anëtar i jashtëm nga Kosova nga komuniteti shkencor;
- Një anëtar ndërkombëtar

Mandati i Bordit është katër vjet.

Neni 6

Bordi është përgjegjës për miratimin e programit vjetor të institutit hulumtues.

Neni 7

Drejtori i institutit duhet t'ia paraqesë Bordit programin e punës së institutit deri më 31 nëntor të vitit përkatës akademik.

Neni 8

Drejtori duhet t'i raportojë prorektorit për hulumtime shkencore për punën e institutit rregullisht në baza mujore.

Neni 9

Drejtori dorëzon raport për punën e institutit rektorit një herë në vit.



KOLEGJI ESLG

Neni 10

Aktivitetet e instituteve hulumtues financohen nga sa vijon:

- nga buxheti i Universitetit
- Nga buxheti i shtetit
- Nga grantet
- Nga aktiviteti vetanak biznesor i instituteve
- Nga burimet tjera.

Prishtinë

20.08.2019

Presidenti i Bordit Menaxhues

Prof. Dr. Edmond Hajrizi



